



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**Anr. 292/2014**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), paraqitur kundër Arsim Kuçi anëtarë i subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për shkak të ndikimit tek votuesit gjatë ditës së zgjedhjeve, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me dt. 12.06.2014, mori këtë:

### **VENDIM**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV)

### **Arsyetim**

PZAP-i, më datë 09.06.2014 ka pranuar një ankesë nga subjekti politik LVV, me të cilën pretendohet se me datën 08.06.2014 rreth orës 08:36 në gjimnazin “Jeta e Re” një anëtarë i LDK-së me emrin Arsim Kuçi ka qëndruar rreth një orë në oborrin e shkollës duke bërë presion tek qytetarët për të votuar LDK-në. Me këtë veprim sipas parashtruesit të ankesës është shkelur neni 36.1 i LZP-së. Këto shkelje sipas parashtruesit të janë raportuar nga aktivistja e LVV-së Vlora Bytyqi

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik LDK për ankesën që është bërë ndaj saj dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës në fjalë deri më datë 11.06.2014 deri në ora 10:00

PZAP-i, brenda të paraparë pranoi përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik LDK, në të cilën përgjigje theksohet se lidhur me ankesën në fjalë konsideron se ajo është pabazuar për faktin se nuk dëshmohet me kurrfarë prove materiale.

Lidhur me këtë çështje PZAP-i e informoi Policinë e Kosovës dhe kërkoi informata më të hollësishme për këtë rast.

Në raportin e policisë të Kosovës theksohet se policia e Kosovës së bashku me prokurorin kujdestar kanë qenë në vendin e cekur në ankesë dhe se gjatë kohës kur ishin atje nga askush nuk është raportuar për ndonji parregullsi dhe se votimi ka vazhduar pa probleme. Më tutje në raportin e policisë theksohet se është kontaktuar

edhe Fadil Elshani menaxheri i kësaj pike zgjedhore e i cili kishte informuar se nuk kishte pranuar asnjë ankesë nga ndonjë qytetar apo nga ndonjë përfaqësues i subjekteve politike, dhe se po i njëjti në prezencën e policisë dhe prokurorisë kishte kontaktuar edhe me Vlora Bytyqin duke kërkuar nga ajo që ta paraqes personin i cili kishte bërë ndonjë parregullsi, për të cilën e njëjta kishte deklaruar se nuk ka ndonjë emër për ndonjë nga parregullsit e bëra nga dikush

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

### **ankesa është e pabazuar**

PZAP-i gjeti se pretendimet e tilla ankimore nuk qëndrojnë pasi që nuk ka prova të mjaftueshme me të cilat do të vërtetohej ajo për të cilën thuhej në ankesë ,kjo vërtetohet edhe nga raporti i policisë e cila së bashku me prokurorin kujdestar ishte në vendin e ngjarjes dhe se gjat kontaktit që kanë pasur me personat përgjegjës në këtë QV dhe gjatë kontaktit që kanë pasur me Vlora Byryqin nuk është raportuar dhe nuk ka pasur ndonjë emër apotë ndonjë vëzhguesi apo ndonjë dëshmitari që ka parë ndonjë parregullsi që ka ndodhur në vendin ku është pretenduar me ankesë. PZAP-i vendosi se pretendimet e tilla janë të pa argumentuar dhe të pa bazuar me fakte dhe me dëshmi konkrete, dhe se nje tankesë e tillë është e pa bazë, andaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr. 292/2014 më datën 12.06.2014



#### ***Udhëzim Juridik:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*